



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr.....

Tirane, date/...../2014

Drejtuar: Z. Festim Ballo, Administrator
Shoqëria "BALLO" Sh.p.k
Rruga "Pandi Dardha", pall.32

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

ZRRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Z. ARDIAN MAÇI, DREJTOR I PERGJITHSHEM
QENDRA KOMBETARE E LICENCIMIT

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi revokimin e lejes nr.1206 datë 02.07.2008.

I nderuar zoti Ballo,

Shoqëria "BALLO" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1206, datë 02.07.2008, për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror , në qarkun Tirane.

Nga struktura përgjegjëse, AKBN me shkresën nr.1912, datë 25.02.2014, është propozuar revokimi i lejes nr.1206, datë 02.07.2008, për arsye se nuk janë paguar garancitë financiare për rehabilitimin e Mjedisit, për periudhën e viteve 2011 dhe 2012, duke mos respektuar kërkesat e pikës ç, nenit 47, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë".

Për shkeljen e mësipërme të ligjit, ne zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" (ku sipas nenit 57 pika 2 dhe 3, përcaktohet shtrirja e efekteve për lejet e dhëna), me shkresën tone nr.1532 date 07.03.2014, *ju jeni njoftuar se ka filluar procedura e revokimit të lejes nr.1206 datë 02.07.2008 dhe ju bënim me dije se brenda një periudhe 30 ditore nga ky njoftim merret vendimi për revokimin e lejes minerare për shkaqet që cituam si me sipër.*

Duke qene se nga ana juaj nuk u ndërmor asnjë veprim për te paguar detyrimet qe ishin shkaku ligjor, për te cilën ju u njoftuat për fillimin e procedurave te revokimit te lejes qe ju zotëroni ju njoftojmë se:

Ne zbatim nenit 48 pika 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” revokohet leja minerare nr.1206, datë 02.07.2008, për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror , në Qarkun Tirane.

Bazuar ne nenin 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” keni detyrimin ligjor te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Kunder këtij vendimi behet ankim ne gjykatën administrative, sipas legjislacionit ne fuqi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

Miratoi: 1. Koli Bele, *Sekretari Përgjithshëm*
2. Mehmet Hasalami, *Drejtor*

Konceptoi: 1.Kujtim Gjoka, *Shef sektori*
2. Erik Skendaj, *Jurist*
2. Luljeta Kraja, *Specialist*
3. Zef Lleshi, *Specialist*